



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E FINANCËS BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 6169 prot.

Vlorë, më 23.04 2024

PROJEKT-VENDIM
Nr. _____, Datë _____.____.2024

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB NR.100, DT.29.12.2023
PËR BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2024”**

Në bazë të Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 8, pika 2, 9 pika 1.1 b, 34, 35, 36, 37,40, 41, 54 pika dh, dhe neni 64 pika c , Ligji nr.68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 45, Ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 44 ; Udhëzimi i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarte të Menaxhimit të Buxhetit”, Udhëzimi plotësues nr.2 datë 28.02.2024 “Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2024”, V.K.B nr.100 datë 29.12.2023 “Për Miratimin e Buxhetit të Bashkisë për Vitin 2024”.VKB nr 29 datë 28.03.2024 “Për disa ndryshime ne V.K.B nr.100 datë 29.12.2023 Miratimin e Buxhetit të Bashkisë për Vitin 2024”.

VENDOSI:

- 1.Të miratojë projektin e Ndërtimit të Rrugës së 7 Pallateve me vlerë 14,902,000 lekë,
2. Në investimet e bashkisë me kod program 6260, të pakësohet fondi prej 14,902,000 lekë, në llogarinë ekonomike 231 në objektin ”Reabilitimi i Lulishteve dhe Hapsirave të Gjellërta në Qytet dhe të shtohet në llogarinë ekonomike 231 investime programi 4520 në objektin “ Ndërtimi i Rrugës së 7 Pallateve me vlerë 14.902.000 si dhe të pakësohet programi me kod 1110 fondi prej 9,520,000 lekë në llogarinë ekonomike 231 me objekt “Rikonstruksion I varrezave të qytetit” dhe të shtohet në programin 1320 (mirembajtje varreza) fondi prej 9,520,000 lekë në llogarine 602 (shpenzime operative) si më poshtë:
 - a) Pakësohen Investimet ne Programet (6260) (1110)

G	Titull	Kap	600	601	602	231	
00	6260	5				14.902.000	Reabilitimi I Lulishteve dhe Hapsirat Publike Ne Qytet
00	1110	1				9,520,000	Investime në Varrezat e qytetit

- b) Shtohet Investimet dhe shpenzimet operative në programet (1110)

G	Titul	Kap	600	601	602	231	
00	01320	1			9,520,000		Mirëmbajtje varrezash

b) Shtohet Investimet në Programin (4520)

G	Titull	Kap	600	601	602	231	Ndërtimi I Rrugës së 7 Pallateve
00	4520	5				14.902.000	

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë .

4. Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në VKM nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 55, pika 6.

KRYETAR

Ermal Dredha





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
DREJTORIA E FINANCËS BUXHETIT DHE KONTABILITETIT

Nr. 616P prot.

Vlorë, më 23.04 2024

RELACION

**MBI PROJEKT-VENDIMIN “PËR NJË RISHPËRNDARJE TË FONDIT TË
INVESTIMEVE TË PARASHIKUAR NË VKB NR.100, DT.29.12.2023, PËR
BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2024 I NDRYSHUAR ”**

Të nderuar Këshilltarë,

Projekt-vendimi që po ju paraqesim për miratim lidhet me realizimin e projektit “Ndertimi i Rruges së 7-të Pallateve “si dhe fondet financiare për realizimin e projektit .

Rruga ne projekt është një nga rrugët e domosdoshme per tu realizuar me qellim permiresimin e qarkullimit te automjeteve ne zonen e 7 pallatave. Ajo ndodhet në zonë të populluar dhe me atraksion turistik. Është rrugë që lidhet me rrugë te cilat kane akses direkt ne zonen e Lungomares Vlore dhe i shërben nje lagjie me banesa të ndërtuara rreth viteve 90.

Gjendja ekzistuese e saj paraqitet teper e amortizuar dhe jo sipas standarteve te kerkuara te nje turizmi elitare. Deri me sot kjo rruge eshte mirembajtur nga banoret e zones me investime rastesore.

Eshtë menduar realizimi i nje segmenti rrugor me gjeresi 6 m.

Fondet në shumën prej 14.902.000 lekë për këtë projekt do të pakesohen nga fondet e Bashkisë për Hapësirat e Gjelbërta.

Gjithashtu në këtë projekt-vendim duke parë kërkesat dhe analizuar situatat ndermarja e shërbimeve publike kërkojnë të bëjnë një ndryshim për nevoja të shërbimit të varrezave nga zëri investime në zërin shpenzime.

Zeri investime perfaqesonte kryesisht mbushje me cakell ndersa shpenzimet do te jene blerje materialesh per prodhim te pllakave te betonit per varrezat.Kjo do te behet per tju pergjigjur ne kohe kerkesave te qytetareve.

Fondet në shumën prej 9,520.000 lekë do të pakesohen nga fondet e Ndermarjes se Sherbimeve Publike nga zeri investime ne zerin shpenzime.

Në këto kushte kërkojmë nga ana e Këshillit të Bashkisë ta miratojë këtë Projekt-Vendim, me qëllim për t'i hapur rrugë procedurave të mëtejshme në funksion të realizimit të projektit të sipercituar gjë që do të mundësojë rritjen e cilësisë së shërbimeve të administratës së bashkisë me qytetarët

KRYETAR

Ermal Dredha





BASHKIA VLORE – DREJTORIA E URBANISTIKES

RIKONSTRUKSION VAZHDIMIT TE RRUGES NE ZONEN E 7 PALLATEVE

RELACION PERSHKRIMI





[Type here]

[Type here]

[Type here]



[Type here]

[Type here]


[Type here]



Shtresat e trupit te rruges do te jene si me poshte:

- Shtrese Cakelli 20 cm
- Shtrese stabilizanti 15 cm
- Shtrese binderi 6 cm
- Shtrese asfaltobetoni 4 cm

Mbas perfundimit te punimeve te ndertimit, do te kryet vijeziimi dhe konturimi i trupit te rruges



Prerje skematike e trupit te rruges

Ing. Darjan Hurdhra

[Type here]

[Type here]

[Type here]